

Në bazë të nenit 8 dhe neni 18 paragrafi (1) nënparagrafi 12 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 nga Ligji i njëjtë dhe neni 16 paragrafi (1) të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, në pajtim me Konkluzionin nr.02-2572/2 datë 27.06.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 20-të mbajtur më 26.6.2023 miratoi si vijon:

V E N D I M

1. Miratohet rritja e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, nr.05-2267/1 datë 30.5.2023.
Të hyrat dhe shpenzimet totale të planifikuara sipas planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, rriten për 300.000,00 denarë, respektivisht arrijnë në 149.830.505,00 denarë.
2. Me rritjen nga pika (1) të këtij Vendimi sigurohen mjete financiare në vlerë të përgjithëshme prej 300.000,00 denarë, të destinuara për:
 - Dhënie të ndihmës financiare – Donacion për Këshillin për Etikë në Media të Maqedonisë, në pajtim me Kërkesën e tyre nr.122-0302 datë 19.6.2023 (Nr.yjnë ark.05-2536/1 datë 20.6.2023), me të cilën kanë kërkuar nga Agjencia për të mundësuar funksionim papengesë të Zyrës ekzekutive dhe Komisionit të ankesave.
3. Sigurimi i mjeteve financiare nga pika (2) e këtij Vendimi kryhet duke ndryshuar pozicionet e mëposhtme:
 - **Të ardhurat në total** rriten për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 149.530.505,00 denarë, arrijnë në 149.830.505,00 denarë;
 - Pika e të ardhurave **Të ardhurat e planifikuara nga kompensimet (tarifat) për lejet për kryerjen e transmetim në radio dhe televizion** rriten për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 26.000.000,00 denarë, arrijnë në 26.300.000,00 denarë;
 - **Shpenzimet e përgjithëshme** janë rritur për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 149.530.505,00 denarë, arrijnë në 149.830.505,00 denarë;
 - Grupi i pikës **450- Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera për subjektet** rritet për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 1.000.000,00 denarë, arrijnë në 1.300.000,00 denarë;
 - Pozita **450100 - Ndihma, donacione dhe pagesa të tjera për subjektet,** rriten për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 1.000.000,00 denarë, arrijnë në 1.300.000,00 denarë. Mjetet e shtuara prej 300.000,00 denarë janë të destinuara për Këshillin për Etikë në Media të Maqedonisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele duhet të rrisë planin financiar të Agjencisë për vitin 2023, me qëllim të sigurimit të mjeteve destinuar për ndarjen e ndihmës financiare – donacion për Këshillin për etikë në media të Maqedonisë, në pajtueshmëri me Kërkesën e tyre nr.122-0302 datë 19.6.2023 (Nr.y në ark.05-2536/1 datë 20.6.2023), me të cilën kërkojnë donacion nga Agjencia për të mundësuar funksionimin papengesë të Zyrës Ekzekutive dhe Komisionit të Ankesave. Për të siguruar 300.000,00 denarë është e nevojshme të bëhen ndryshime në këto pika në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, përkatësisht: Pika e të ardhurave **Të ardhurat nga kompensimet për lejet për kryerjen e transmetim në radio dhe televizion** rriten për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 26.000.000,00 denarë, arrijnë në 26.300.000,00 denarë. Pika e grupit **450 – Ndhima, donacione dhe pagesa të tjera për subjektet** rriten për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 1.000.000,00 denarë, arrijnë në 1.300.000,00 denarë. Pozita **450100 – Ndhima, donacione dhe pagesa të tjera për subjektet** është rritur për 300.000,00 denarë dhe në vend të shumës së mëparshme prej 1.000.000,00 denarë, arrijë në 1.300.000,00 denarë.

Gjegjësisht, me rritjen e propozuar të planit financiar për vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet totale të planifikuara sipas planit rriten për 300.000,00 denarë dhe arrijnë në 149.830.505,00 denarë.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 8 dhe nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 12 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 nga Ligji i njëjtë dhe neni 16 paragrafi (1) të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, në pajtim me Konkluzionin nr.02-____/___ datë _____2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 20-të mbajtur më 26.6.2023, miratoi Vendim si në dispozitiv.

Nr. 05-2635/1

27.06.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.